



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSBC), në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me kohë të plotë, specialist i kurrikulës dhe statistikës.

Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ, specialisti i kurrikulës dhe statistikës, vlerëson sipas standardeve planet mësimore të paraqitura nga njësitë bazë e kryesore; ndjek procesin e regjistrimeve, transferimeve të studentëve në të gjitha ciklet e studimit; auditon realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik; përgatit databaza përkatëse të regjistrimit të studentëve dhe realizimit të ngarkesave mësimore si dhe evidence periodike. Raporton periodikisht për veprimtarinë e punës.

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta.

Kritere të përgjithshme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master) në fushën e shkencave edukimit. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë përvojë pune.
- Të jetë i aftë për punë

Kritere të veçanta:

- Të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë të mëparshme pune në institucione arsimore;
- Të ketë njohuri bazë mbi legjislacionin e arsimit të lartë dhe njohuri mbi institucionet bashkëpunuese;
- Të ketë njohuri të elementeve të programeve sipas cikleve të studimit, procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programve të studimit;
- Të ketë aftësi organizative dhe të bashkëpunimit në grup;
- Njohës i mirë i përdorimit të programeve kompjuterike;
- Të ketë njohuri të një ose disa gjuhëve të huaja të vertëtuara me dokumentacion;
- Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Çdo kandidat duhet të deklarojë se nuk ka konflikt interesi në përputhje me ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**16.06.2025 – 25.06.2025**), nga data e shpalljes në www.app.gov.al. dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës, specialist i kurrikulës dhe statistikës në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave (Ministria përgjegjëse për arsimin)
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave (Ministria përgjegjëse për arsimin)
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetësore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetësore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (**16.06.2025 – 25.06.2025**), nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist i kurrikulës dhe statistikës.*
Elbasan



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtrohen intervistës me gojë (30.06.2025 – 16.07.2025). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.